

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
01	16.02.2026	Ju lutem vini në dispozicion listën e plotë të operatorëve ekonomikë me licencë aktive për shfrytëzim të fondit pyjor në Republikën e Shqipërisë. Konkretisht, cilët operatorë ekonomikë kanë licencë dhe kryejnë prerje të pyjeve në territorin e Shqipërisë. Për secilin operator, ju lutem specifikoni, numrin e licencës, datën e lëshimit, afatin e vlefshmërisë, llojin e aktivitetit të licencuar. Ju lutem vini në dispozicion listën e parcelave pyjore të dhëna në shfrytëzim gjatë 3 viteve të fundit. Për çdo parcelë të dhënë në shfrytëzim, specifikoni subjektin përfitues, vendndodhjen (njësia administrative / zona), sipërfaqen, volumin e miratuar për prerje, afatin e kontratës. Ju lutem vini në dispozicion procesverbalet e kontrollit dhe raportet e inspektimit apo gjobat e vëna (nëse ka) për subjektet që ushtrojnë aktivitete shfrytëzimi pyjor	09.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj për informacion, ju informojmë se Agjencia Kombëtare e Pyjeve (A.K.P) nuk disponon informacion lidhur me subjektet e licencuara, pasi licencimi i subjekteve, si dhe dhënia e lejeve për shfrytëzim, janë kompetencë e Ministrisë së Mjedisit. Gjithashtu, në përgjigje të pikës nr. 3 të kërkesës suaj, ju sqarojmë se Agjencisë Kombëtare të Pyjeve i janë hequr kompetencat ligjore në fushën e inspektimit, në zbatim të ligjit të ri për inspektimin, bashkitë kanë strukturat e tyre të inspektimit dhe për rrjedhojë A.K.P nuk ushtron më funksione inspektuese në këtë drejtim. Për këtë arsye, për marrjen e informacionit të kërkuar, ju sugjerojmë t'i drejtoheni institucionit përgjegjës, Ministrisë së Mjedisit. Duke ju falënderuar për mirëkuptimin, mbetemi në dispozicion për çdo sqarim tjetër brenda fushës së kompetencave tona.	E plotë	0

		për prerjen e drurëve/pemëve/pyjeve.				
02	05.04.2026	A është paraqitur pranë Agjencise ndonjë aplikim për leje për ndërtimin e një impianti fotovoltaik në zona pyjore kullosore në njesite administrative Labinot Mal, Paper, Shushicë? Nëse po, ju lutemi specifikoni emrin e subjektit aplikues, kapacitetin e projektit (MW), datën e aplikimit dhe statusin aktual të shqyrtimit? A është miratuar apo është në proces miratimi ky projekt nga ana e ministrisë? Nëse po, ju lutemi të vini në dispozicion kopje të vendimeve përkatëse (përfshirë VKM, nëse ekziston), dokumentacionin teknik dhe përshkrimin e projektit? A është dhënë ndonjë leje paraprake apo autorizim për zhvillimin e këtij projekti? Nëse po, cilat janë kushtet dhe kriteret e vendosura? A ka kaluar projekti procedurën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM)? Nëse po, ju lutemi të vini në dispozicion raportin përkatës ose një përmbledhje të tij? A ka bashkëpunim institucional me organe të tjera (p.sh. Agjencia Kombëtare e Pyjeve, Këshilli Kombëtar i Territorit) lidhur me	15.04.2026	Në përgjigje të kërkesës suaj lidhur me ndërtimin e një impianti fotovoltaik në zonat pyjore, kullosore në njesitë administrative Labinot Mal, Paper dhe Shushicë, ju bëjmë me dije si më poshtë: Në çdo rast, theksojmë se, në përputhje me ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, si dhe legjislacionin në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, administrimi, përdorimi dhe dhënia në përdorim e sipërfaqeve pyjore është kompetencë e bashkive përkatëse, në cilësinë e tyre si administratore të këtij fondi. Pranë Agjencisë Kombëtare të Pyjeve nuk është paraqitur asnjë aplikim për leje për ndërtimin e impianteve fotovoltaike në zonat e sipërpërmendura. Për rrjedhojë, nuk disponojmë të dhëna lidhur me subjekt aplikues, kapacitet projekti (MW), datë aplikimi apo status shqyrtimi. Agjencia Kombëtare e Pyjeve nuk ka informacion mbi ndonjë projekt të miratuar apo në proces miratimi nga ana e ministrisë përgjegjëse, si dhe nuk disponon vendime përkatëse (përfshirë VKM) apo dokumentacion teknik për një projekt të tillë.	E Plotë	0

		këtë projekt? Nëse po, cilat janë rolet dhe përgjegjësitë e secilit institucion? A ka zhvilluar ministria konsultime publike apo dëgjesa me komunitetin lokal lidhur me këtë projekt? Si vlerëson ministria përputhshmërinë e këtij projekti me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e fondit pyjor dhe përdorimin e territorit?				
--	--	--	--	--	--	--